

## KONTRATË SHITJE

Sot më datë **01.10.2019** palët pjesmarrëse kanë rënë dakort për lidhjen e kontratës së mëposhtme”

### PALËT PJESMARRËSE NË KONTRATË :

**Arjodita Rraboshta**, shtetase shqiptare, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi **I55712097Q**, lindur më **12.07.1985**, Shkodër, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri (Shitesi)

**Arsid Rraboshta**, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi **I30419101R**, lindur më **19.04.1983**, Shkodër, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Blersi)

### Neni 1

### OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është shitja pjesore e kuotave zotëruese nga Arjodita Rraboshta, te cilat përfaqësojnë 100 % të kapitalit të shoqërisë “**MIAIR**” me numër unik (NUIS) **L61426009D**, me adresë Njesia bashkiake nr 5, rruga Medar Shtylla, kompleksi Kika, ndertesa nr 43, kati 2 ,Tirane

- Shitjen e kuotës zotëruese nga Arjodita Rraboshta i cili përfaqëson **100 %** të kapitalit të shoqërisë “**MIAIR**”



## Neni 2

### Cmimi

Cmimi i shitjes së 1 (një) kuote e cila përfaqëson 100 % të kapitali të shoqërisë “Miair” është 100,000 LEK .

## Neni 3

### Afati i pagimit te cmimit

Pagimi i cmimit do të kryhet pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

## Neni 4

### Të drejtat dhe detyrimet e shitesit

1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë nga blerësi pagimin e cmimit ne mënyrën dhe afatin e parashikuar në këtë kontratë.
2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzoje blerësit të gjithë dokumentacionit që shënon të drejtën e pronësisë dhe që janë të nevojshme për kalimin e saj.
3. Shitësi duhet te garantoje bleresin per gezimin e qetë te kuotave nga cdo e drejtë pronësie të personave të trete. Shitësi është i detyruar të marrë pjesë në gjykim në mbështetje të blerësit nese ai thirret prej tij, për ta garantuar ndaj pretendimeve te personave te trete, mbi kuotat objekt i kontrates.

## Neni 5

### Te drejtat dhe detyrat e bleresit

1. Bleresi ka të drejtë te kërkojë dokumentat qe vërtetojnë pronësinë e shitësit mbi kuotat, objekt kontrate nga shitesi nga e nesermja e hyrjes ne fuqi të kësaj kontrate.
2. Bleresi eshte i detyruar të marrë në zotërim vendin ku shoqëria ka qendrën e ushtrimit të aktivitetit



**Neni 6**  
**Zgjidhja e kontratës**

1. Shitesi ka të drejtë të kërkojë të zgjidhe kontraten kur:

- a) blerësi nuk paguan cmimin.
- b) blerësi nuk merr në dorëzim objektin ku shoqëria ushtron aktivitetin , brenda 15 ditëve nga afati shtesë i caktuar nga shitësi;
- c) blerësi nuk merr në dorëzim dokumentat e pronësisë së kuotave

2. Bleresi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur:

- a) shitësi nuk dorëzon dokumentat e pronësisë së kuotave
- b) shitësi nuk dorëzon objektin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, objekt kontrate brenda afatit shtesë 10 ditor, të caktuar nga blerësi ;
- b) shitesi deklaron brenda afatit 10 ditor se nuk do të dorëzojë dokumentacioni dhe objektin e ushtrimit të aktivitetit;

**Neni 7**  
**Pasojat e zgjidhjes se kontrates**

1. Shitësi me zgjidhjen e kontratës duhet t'i kthejë pagesat e bëra blerësit, dhe gëzon të drejtën për shpërblimin e dëmit .

**Neni 8**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Në rast mosmarrëveshje midis tyre palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim, dhe vetëm kur një gjë e tillë është e pamundur ato do t'i drejtohen gjykates se "Rrethit Gjyqësor Tiranë".



## Neni 9

### Shpenzimet per lidhjen e kontratës

Shpenzimet për lidhjen e kësaj kontrate i ngarkohen te dyja palëve përkatësisht.

## Neni 10

### Momenti i kalimit të pronësisë dhe Hyrja në fuqi

Kuotat zotëruese të ortakut **Znj. Arjodita Rraboshta** në shoqërinë "**Miair**" Shpk në datën **01.10.2019** kalojnë në pronësi të **Z. Arsid Rraboshta** si më poshtë:

Kuota zotëruese nga **Znj. Arjodita Rraboshta 100%** të kapitalit të shoqërisë I kalon **Z. Arsid Rraboshta**.

Pas ndryshimi kuotat zoteruese behen :

**Z. Arsid Rraboshta 100 %** zoterus i kapitalit te shoqerise Miair shpk.

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën **01.10.2019**.

## Neni 11

### Hartimi i kontratës

Kjo kontratë u hartua në **2 (dy)kopje** nga një për secilën palë.

### PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSIT :

Arjodita Rraboshta

*Arjodita Rraboshta*  
*Arjodita Rraboshta*

BLERESI :

Arsid Rraboshta

*Arsid Rraboshta*  
*Arsid Rraboshta*

